



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300242/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Marrja e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, me qëllim garantimin e ushtrimit lirisht të së drejtës së tyre kushtetuese, të votës për personat me aftësi të kufizuar, në Zgjedhjet Vendore 2023.*

Drejtuar: *Bashkive të Qarkut Tiranë
Bashkive të Qarkut Kukës
Bashkive të Qarkut Korçë
Bashkive të Qarkut Gjirokastër
Bashkive të Qarkut Durrës
Bashkive të Qarkut Dibër
Bashkive të Qarkut Shkodër
Bashkive të Qarkut Fier
Bashkive të Qarkut Elbasan
Bashkive të Qarkut Berat
Bashkive të Qarkut Vlorë
Bashkive të Qarkut Lezhë*

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit kushtetues, për parandalimin e shkeljes, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, ka si një nga prioritetet e aktivitetit të tij, mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Duke qenë se e drejta e votës së lirë, të fshehtë dhe të barabartë është një nga të drejtat themelore dhe të patjetërsueshme të njeriut, institucioni i Avokatit

të Popullit në vijimësi ka vënë theksin te ushtrimi efektiv i kësaj të drejte nga të tëra grupet shoqërore në vend e në këtë kuadër vëmendje të shtuar merr krijimi i kushteve të përshtatshme për të ushtruar këtë të drejtë për personat me aftësi të kufizuara, me akses të garantuar në qendrat e votimit.

Detyrimi për t'iu garantuar personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, rrjedh ndër të tjera specifikisht, nga Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Avokati i Popullit është një institucion monitorues për zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Në nenin 29 të Konventës, për pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike, është përcaktuar se:

“ Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër:

(a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:

(i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;

(ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;

(iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.”

Sa më sipër është marrë në konsideratë nga Shteti Shqiptar, i cili të drejtën e votës, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si e drejtë kushtetuese parashikohet shprehimisht në Kushtetutën e Shqipërisë, në nenin 45 të saj, ku thuhet se:

- *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet” ;*

Gjithashtu në ligjin nr.100129, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kjo e drejtë kushtetuese rikonfirmohet edhe si

parim bazë i këtij kodi si dhe detajohen në mënyrë të qartë mënyrat e ushtrimit të kësaj të drejte. Sipas nenit 3, pika b:

- “...b) Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”.

Kodi ynë zgjedhor, në nenin 108 të tij, ka përcaktuar procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, infrastrukturës së përshtatshme për lehtësimin e pjesëmarrjes në votime për personat paraplegjike e tetraplegjike, pajisjen e komisioneve të qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi për personat që nuk shikojnë.

Rregullat që do të ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, janë përcaktuar në Udhëzimin nr.1 datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas këtij udhëzimi, në pikat 2 dhe 3 të nenit 3, përcaktohet se:

“2. Qendrat e votimit krijohen:

- a) Për aq sa është e mundur në ndërtesa publike me hyrje të lirë;*
- b) Në ndërtesa të institucioneve publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore ku përfshihen, shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore;*
- c) Në institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë.*

3. KQZ mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private, kur në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ-së, caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridikë. Propozimi paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e

përcaktuara në këtë nen, bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ”.

Në nenin 8 të Udhëzimit, *Shpallja dhe njoftimi i vendndodhjes së qendrave të votimit*, në gërmën “b”, pika 1, përcaktohet se:

“1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore:

b. Cakton në katet e para të ndërtesave, si rregull, qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara“.

Është domosdoshmëri që në çdo qendër votimi duhet të ketë një standard minimal kushtesh që lehtëson aksesin gjatë gjithë procesit të votimit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, të cilat lidhen me sigurimin dhe vënien në funksionim të logjistikës së nevojshme si dhe të përcaktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit.

Respektimi i këtyre kushteve duhet të vlerësohet nga ana e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmbushjen e plotë dhe të përshtatshme të tyre.

Ndonëse për mosplotësim të standardit të treguar në Udhëzim nuk ka sanksion, Avokati i Popullit vlerëson se në veçanti në zgjedhjet lokale pushteti vendor duhet të tregojë kujdes maksimal për të tërë qytetarët e njësisë territoriale për të shprehur vullnetin e tyre.

Në dispozitat e tij, Udhëzimi nr.1, datë 5.12.2020, detajon detyrimet dhe garancitë e dhëna në Kodin Zgjedhor, pasi shprehet për marrje masash dhe për krijim lehtësirash nga ana e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet qendra e votimit, për votimin e personave me aftësi të kufizuara.

Nga monitorimi i kryer për zgjedhjet e përgjithshme 2021 këto parashikime nuk janë zbatuar në një numër jo të vogël qendrash. Në përgjithësi qendrat e votimit të vendosura në katet e para të godinave kishin aksesueshmëri për personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, pasi kishin rampë në hyrje të godinave. Në rastet kur qendrat e votimit ishin parashikuar të vendoseshin në ambiente në katin e dytë të godinave përkatëse, u konstatua se për aksesueshmërinë e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nuk ishin parashikuar masa specifike. Shiritat e verdhë, për aksesueshmërinë e personave që nuk shikojnë, mungonin totalisht në të gjitha qendrat e votimit të inspektuara.

Avokati i Popullit vë theksin se mungesa e lehtësive të përshtatshme për votimin e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, mund të konsiderohet edhe si një kufizim, apo pengesë, ndaj të drejtës së tyre, të votës. Kjo mungesë nuk mund të ketë justifikim.

Në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2023, Avokati i Popullit në përputhje

me përcaktimin e dhënë në paragrafin e parë, të nenit 2, të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Duke qenë nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend”,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e ushtrimit lirisht të së drejtës së tyre kushtetuese, të votës, në Zgjedhjet Vendore, më datë 14 Maj 2023.

Po e dërgojmë këtë rekomandim për ta patur përsëri në vëmendje dhe se në kuptim të mandatit tonë, ne do të monitorojmë garantimin e kësaj të drejte dhe do paraqesim një raport për disa bashki.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit midis institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, mbetemi në pritje të përgjigjes.

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA